

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar me:		
Prilajeno: 20.04. 2022		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
5-453/04	20303	



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIK OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 20.04.2022

Bazuar në Rregulloren e MF – NR-04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve :

Zyra e Kryetarit të Komunës së Lipjanit dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në zbatim të objektivës: Mjedisi, shëndeti dhe siguria e të rinjve.

Kulturë, Sport dhe Rekreacion

1. Komuna e Lipjanit, gjegjësisht Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përputhje me Strategjinë Nacionale për Rini 2019-2023 dhe Planin e Veprimit për Rini 2019-2023 u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, që veprimtarin e vet e kryejnë në Komunën e Lipjanit , që programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e mjedisit të shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në këtë objektivë.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre në kuadër të objektivës **Mjedisi, shëndeti dhe siguria e të rinjve:**

Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore përmes aktiviteteve të ndryshme rinore, kulturore dhe rekreative

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e sektorit të rinisë përmes aktiviteteve si më poshtë:

- ✓ Integrimi shoqëror i të rinjve përmes kulturës, sportit dhe rekreacionit
- ✓ Rritja e kohezionit social ndëretnik në mes të rinjve
- ✓ Mbështetja e femrave të reja dhe të rinjve në zonat rurale
- ✓ Rinia, kontribues në Rehabilitimin PasCovid
- ✓ Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 30,000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 501,00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5,000.00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 10.05.2022

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e rinisë përkatësisht të komponentës së pjesëmarrjes. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesve të mbështetjes financiare publike. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqes prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (www.komunaelipjanit-ks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e më poshtme:

Komuna e Lipjanit
Rruga „Shqiperia” Lipjan
Zyra për shërbim me qytetaret nr.3
14000 Lipjan

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: bekim.zaskoku@rks-gov.net.

z. Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit

për: 

